



KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

PROCES VERBAL

Mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejës për muajin Nëntor 2025

Data 26.11.2025 ora 14:00.

Mbledhja zhvillohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat.

Rendi i dites:

- 1.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes datë 27.10.2025, si dhe informacion për VKB-të e marra në këtë mbledhje.
2. Projekt vendim për humbjen e mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.
- 3.Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Tetor 2025.
- 4.Projekt vendim për miratimin e subvencionit të qirasë dhe vlerën e përfitimit për znj.Gjovana Marku (Peci) dhe z.Afrim Marku në programin e strehimit "Subvencioni i qirasë në tregun e lirë"
- 5.Projekt vendim për ndryshimin e vkb nr.84 datë 23.12.2024 "Për shtesën e tranfertës së pakushtëzuar sektoriale të Bashkisë Vau Dejës" sipas aktit normativ nr.10 datë 08.10.2025 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.115/2024 për buxhetin e vitit 2025".
- 6.Projekt vendim për pranimin e të moshuares Znj..Age Tavasija në qendren e përkujdesit rezidencial për të moshuar "Besa" Barbullush.
- 7.Projekt vendim"Për rishqyrtimin e Vendimit Nr.46, datë 29.08.2025 të Këshillit Bashkiak "Për dhënien në përdorim me afat 10 vjeçar sipërfaqen prej 5 ha "Për aerogjeneratorë (stacionet, objektet përkatëse etj) dhe 3.909 km (3 km e 909 m) rrugë për tu lidhur me sipërfaqen që do të jepet në përdorim, 6.709 km (6 km e 709 m) linjë transmetimi të energjisë elektrike në ekonomitë pyjore Gjadër Mnelë"
- 8.Projekt vendim "Për një ndryshim dhe shtesë në Vendimin Nr.37, datë 24.05.2024 të Këshillit Bashkiak "Për dhënien në përdorim me afat 9 vjeçar sipërfaqen prej 0.5 ha për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësorë, shoqërore dhe për veprimtari turistike, kampingje (kënde lojërash, mjedise sportive, shplodhëse, kulturore, agroturizëm etj) në ngastrën 3b ekonomia Gjadër Mnelë"
- 9.Projekt vendim "Për rishqyrtimin e Vendimit Nr.44, datë 29.08.2025 të Këshillit Bashkiak "Për dhënien në përdorim me afat 10 vjeçar për aerogjeneratorë sipërfaqe prej 5.3 ha dhe 5.258 km rrugë për lidhje me sipërfaqen në ekonominë pyjore Gjadër Mnelë"
- 10.Projekt vendim"Për rishqyrtimin e Vendimit Nr.45, datë 29.08.2025 të Këshillit Bashkiak "Për dhënien në përdorim me afat 10 vjeçar sipërfaqes prej 3 ha "Për aerogjeneratorë (stacionet, objektet përkatëse etj) dhe 4.063 km (4 km e 63 m) rrugë për tu lidhur me sipërfaqen që do të jepet në përdorim në ekonomitë Gjadër Mnelë".



11.Shqyrtim dhe diskutim i peticionit “Për hapjen e një çerdhe-kopështi publik me drekë në Bashkinë Vau Dejës.

12.Të ndryshme.

Grupe interesi nuk kishte prezent.Votimet do bëhen të hapura.

Mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejes u zhvillua me datë 26.11.2025 ora 14.00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat. Fillimisht u bë apeli i këshilltarëve që ishin prezent në sallë, nga ana e sekretarit të Këshillit Bashkiak, Z.Ardian Çelepija.Të pranishëm në sallë ishin 16 këshilltarë,(Ervis Shimaj, Frano Prenga, Majlinda Ndreca, Rita Preçi, Neki Kapllanaj, Ermir Tahiri, Kastriot Shkjau, Albina Livadhi, Edona Molla, Besmir Kapaj, Sanije Salja, Samed Hasmegaj, Marin Dodaj, Franga Kola, Ornela Lleshi, Martin Mardoda.), korum i mjaftueshëm dhe i nevojshëm për të zhvilluar mbledhjen e këshillit.

Fjalën për të filluar mbledhjen e mori Z.Ervis Shimaj -kryetar i këshillit bashkiak i cili lexoi rendin e dites dhe pyeti këshilltarët nëse ishin dakort me rendin e ditës.Rendi i ditës u miratua me 16 vota Pro. Këshilltarët që votuan pro:(Ervis Shimaj, Frano Prenga, Majlinda Ndreca, Rita Preçi, Neki Kapllanaj, Ermir Tahiri, Kastriot Shkjau, Albina Livadhi, Edona Molla, Besmir Kapaj, Sanije Salja, Samed Hasmegaj, Marin Dodaj, Franga Kola, Ornela Lleshi, Martin Mardoda.)

Z.Ervis Shimaj lexon piken e parë të rendit të ditës:

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes datë 27.10.2025 si dhe informacion për VKB-të e marra në këtë mbledhje.

U pyeten këshilltarët nëse ishin dakort me procesverbalin e mbledhjes së datës 27.10.2025 nga Z.Ervis Shimaj.Këshilltarët nuk kishin pyetje dhe të gjithë shprehen dakortësi për miratimin e tij. Këshilltarët që votuan pro:(Ervis Shimaj, Frano Prenga, Majlinda Ndreca, Rita Preçi, Neki Kapllanaj, Ermir Tahiri, Kastriot Shkjau, Albina Livadhi, Edona Molla, Besmir Kapaj, Sanije Salja, Samed Hasmegaj, Marin Dodaj, Franga Kola, Ornela Lleshi, Martin Mardoda.)

Z.Ervis Shimaj lexon piken e dytë të rendit të ditës:

Projekt vendim për humbjen e mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

Z.Ervis Shimaj spjeron për këshilltarët se për shkak të mungesës 6 muajve rresht në mbledhjet e Këshillit Bashkiak Vau Dejës, e humb mandatin para kohe Z.Aleko Dodani.Komisioni i mandateve në mbledhjen e tij e ka konfirmuar një fakt të tillë dhe ka bërë propozim për humbke maandati para kohe të këshilltarit.

z.Ervis Shimaj pyet këshilltarët nëse kanë diskutime apo pyetje.Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:**Miratohet me 16 vota Pro, zero vota kundra, zero vota absrenim.** Këshilltarët që votuan pro piken e dytë:(Ervis Shimaj, Frano Prenga, Majlinda Ndreca, Rita Preçi, Neki Kapllanaj, Ermir Tahiri, Kastriot Shkjau, Albina Livadhi, Edona Molla, Besmir Kapaj, Sanije Salja, Samed Hasmegaj, Marin Dodaj, Franga Kola, Ornela Lleshi, Martin Mardoda.)



Z.Ervis Shimaj lexon piken e tretë të rendit të ditës:

Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Tetor 2025.

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Znj.Elidona Lisi -perfaqesuese e zyres se ndihmes ekonomike,e cila relaton lidhur me projekt vendimin e paraqitur. Ajo shprehet se projekt vendimi është hartuar bazuar ne ligjin nr. 139, datë 17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar; Ligjin nr. 57/2019, datë 18.7.2019, "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë"; VKM-në nr. 597, datë 4.9.2019, "Për Përcaktimin e Procedurave të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për Ndihmën Ekonomike", të ndryshuar, Si dhe bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 02, datë 27.01.2025, "Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike duke përdorur deri në 6% të fondit të ndihmës ekonomike për vitin 2025"; Shkresën e Prefekturës së Qarkut Shkodër për shprehje ligjshmërie nr. 106/1 prot, datë 11.02.2025.

Ajo shprehet se projekt vendimi propozon qe: 1-Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin Tetor 2025 , familje 131, me 411.359 lekë, me 5.98% e fondit total.

2-Në total për Bashkinë Vau Dejës, për muajin Tetor 2025 janë shpallur fitues, 891 familje, me fond 6.864.461 lekë, nga ku 6% e këtij fondi është 411.867 lekë.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:

Miratohet me 16 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim. Këshilltarët që votuan Pro piken e tretë të rendit të ditës: (Ervis Shimaj, Frano Prenga, Majlinda Ndreca, Rita Preçi, Neki Kapllanaj, Ermir Tahiri, Kastriot Shkjau, Albina Livadhi, Edona Molla, Besmir Kapaj, Sanije Salja, Samed Hasmegaj, Marin Dodaj, Franga Kola, Ornela Lleshi, Martin Mardoda.)

Z.Ervis Shimaj lexon piken e katër të rendit të ditës:

Projekt vendim për miratimin e subvencionit të qirasë dhe vleren e përfitimit për znj.Gjovana Marku (Peci) dhe z.Afrim Marku në programin e strehimit "Subvencioni i qirasë në tregun e lirë"

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Z.Edmond Gjeçaj- specialist pranë zyres së strehimit social, Bashkia Vau Dejës, i cili spjegoi se për hartimin e projekt vendimit është zbatuar me korrektesi baza ligjore dhe se komisioni i Strehimit i ngritur me VKB Nr.21 me 26.03.2025 "Për miratimin e ndyshimit të VKB Nr.33 datë 28.04.2023 dhe VKB Nr.80 datë 30.10.2023 për ngritjen e Komisionit të Strehimit", realizoi mbledhjen në datën 14.11.2025, ku u bë shqyrtimi i dokumentacionit të plotë dhe rezulton se znj.Gjovana Marku (Peci) dhe z.Afrim Marku i plotësojnë kriteret ligjore për përfitimin e "Subvencioni i qirasë, në tregun e lirë" në programin e strehimit.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.



Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:

Miratohet me 16 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim. Këshilltarët që votuan Pro piken e katërt të rendit të ditës: (Ervis Shimaj, Frano Prenga, Majlinda Ndreca, Rita Preçi, Neki Kapllanaj, Ermir Tahiri, Kastriot Shkja, Albina Livadhi, Edona Molla, Besmir Kapaj, Sanije Salja, Samed Hasmegaj, Marin Dodaj, Franga Kola, Ornela Lleshi, Martin Mardoda.)

Z.Ervis Shimaj lexon piken e pestë të rendit të ditës:

Projekt vendim për ndryshimin e vkb nr.84 datë 23.12.2024 "Për shtesën e tranfertës së pakushtëzuar sektoriale të Bashkisë Vau Dejës" sipas aktit normativ nr.10 datë 08.10.2025 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.115/2024 për buxhetin e vitit 2025".

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Z.Marjan Marku specialist pranë zyres financë-buxhetit, Bashkia Vau dejës i cili spjegon për këshilltarët se ky projekt vendim ka për qëllim përmirësimin e Vendimit të Këshillit nr 84 datë 23.12.2024 "Për shtesën e transfertës së pakushtëzuar sektoriale të Bashkisë Vau Dejës, sipas Aktit Normativ nr.10 datë 08.10.2025" për Bashkinë Vau Dejës të konfirmuar nga Prefektura Shkodër me shkresë nr 860/1 prot datë 06.01.2025.

Ministria e Financës me shkresën nr. 14505/11 Prot, datë 08.10.2025, me lëndë "Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr 10 datë 08.10.2025", ka dërguar detajimin e shtesës së fondeve për njësitë e vetëqeverisjes vendore në transfertën e pakushtëzuar sektoriale për funksionin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi Ky fond akordohet për ti ndihmuar bashkitë për shpërblimin e punonjësve të angazhuar në shuarjen e zjarreve, në masën deri në një pagë.

Në shkresë cilesohet që për bashkitë që kanë akorduar shpërblimin e punonjësve të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi nga buxheti i tyre do ta përdorin këtë fond për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

Sipas Vendimit Nr. 483 datë 2.9.2025 PËR DHËNIE SHPËRBLIMI PERSONELIT TË ANGAZHUAR NË OPERACIONET PËR SHUARJEN E ZJARREVE GJATË VITIT 2025, pika 9) Efekti financiar për strukturat e përcaktuara në shkronjën "d", të pikës 2, të këtij vendimi, përballohet nga buxhetet përkatëse të njësive të vetëqeverisjes vendore, ne kemi përdorur fondet nga buxheti i bashkisë për kalimin e shpërblimeve të punonjësve të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi, konkretisht pagesat me urdhër shpenzimi nr 664 dhe urdhër shpenzimi nr 665. Bazur në aktin normativ nr.10 datë 08.10.2025, nëpërmjet këtij projekt vendimi është bërë angazhimi që këto fonde të kalojnë në llogarinë ekonomike 602 për shpenzimet operative, për programin 03280 që të përdoren në vazhdimësi për përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së shërbimit që mbulon ky program.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:

Miratohet me 16 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim. Këshilltarët që votuan Pro piken e pestë të rendit të ditës: (Ervis Shimaj, Frano Prenga, Majlinda Ndreca, Rita Preçi, Neki Kapllanaj,



Ermir Tahiri, Kastriot Shkjau, Albina Livadhi, Edona Molla, Besmir Kapaj, Sanije Salja, Samed Hasmeqaj, Marin Dodaj, Franga Kola, Ornela Lleshi, Martin Mardoda.)

Z.Ervis Shimaj lexon piken e gjashtë të rendit të ditës:

Projekt vendim për pranimin e të moshuares Znj..Age Tavasija në qendren e përkujdesit rezidencial për të moshuar "Besa" Barbullush.

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Znj.Marketa Lleshaj- specialiste pranë zyres ndihmes ekonomike dhe strehimit social e cila relatton për këshilltarët se është pregaditur projekt vendimi për pranimin e të moshuarës Znj.Age Tavasija në qendren e përkujdesit rezidencial për të moshuar "Besa" Barbullush,Znj.Age Tavasija jeton prej disa vitesh e vetme në Nj.A Shllak dhe ka bërë kërkesë për akomodim në qendren e përkujdesit rezidencial për të moshuar "Besa" Barbullush, pasi nuk mund të jetojë e vetme në fshat.Është konstatuar se ajo jeton në kushte të vështira ekonomike dhe nuk ka mbështetje, prandaj kemi propozuar për akomodim në qendren e përkujdesit rezidencial për të moshuar "Besa" Barbullush

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Z.Ermir Tahiri pyet: Sa është kapaciteti i qendres për të moshuar "Besa" Barbullush ?

Znj.Marketa Lleshaj pergjigjet:Aktualisht ka vende bosh dhe ne i bëjmë propozimet duke rakorduar me stafin drejtues të kësaj qendre.

Këshilltarët e tjerë nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:

Miratohet me 16 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim. Këshilltarët që votuan Pro piken e gjashtë të rendit të ditës: (Ervis Shimaj, Frano Prenga, Majlinda Ndreca, Rita Preçi, Neki Kapllanaj, Ermir Tahiri, Kastriot Shkjau, Albina Livadhi, Edona Molla, Besmir Kapaj, Sanije Salja, Samed Hasmeqaj, Marin Dodaj, Franga Kola, Ornela Lleshi, Martin Mardoda.)

Z.Ervis Shimaj lexon piken e shtatë të rendit të ditës:

Projekt vendim"Për rishqyrtimin e Vendimit Nr.46, datë 29.08.2025 të Këshillit Bashkiak "Për dhënien në përdorim me afat 10 vjeçar sipërfaqen prej 5 ha "Për aerogjeneratorë (stacionet, objektet përkatëse etj) dhe 3.909 km (3 km e 909 m) rrugë për tu lidhur me sipërfaqen që do të jepet në përdorim, 6.709 km (6 km e 709 m) linjë transmetimi të energjisë elektrike në ekonomitë pyjore Gjadër Mnelë"

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar Z.Mark Suli- inxhinjer specialist pranë zyres pyjeve Bashkia Vau Dejës, i cili relatton për këshilltarët se është marrë vendim për dhënie në përdorim e sipërfaqes së sipërcituar por institucioni i Prefektit Qarkut Shkodër e ka kthyer për procedurë jo të saktë të cënimit të konkurrimit publik.Projekt vendimi paraqitet për efekt të ndryshimit të procedurave ku



në ndryshim nga Vkb e marrë, duhet të ndiqet procedura për dhënie në përdorim/heqjen nga fondi pyjor dhe kullësor publik mbështetur në Ligjin nr.57/2020 „Për pyjet“

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:

Miratohet me 16 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim. Këshilltarët që votuan Pro piken e shtatë të rendit të ditës: (Ervis Shimaj, Frano Prenga, Majlinda Ndreca, Rita Preçi, Neki Kapllanaj, Ermir Tahiri, Kastriot Shkjau, Albina Livadhi, Edona Molla, Besmir Kapaj, Sanije Salja, Samed Hasmegaj, Marin Dodaj, Franga Kola, Ornella Lleshi, Martin Mardoda.)

Z.Ervis Shimaj lexon piken e tetë të rendit të ditës:

Projekt vendim "Për një ndryshim dhe shtesë në Vendimin Nr.37, datë 24.05.2024 të Këshillit Bashkiak "Për dhënien në përdorim me afat 9 vjeçar sipërfaqen prej 0.5 ha për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësorë, shoqërore dhe për veprimtari turistike, kampingje (kënde lojërash, mjedise sportive, shplohëse, kulturore, agroturizëm etj) në ngastrën 3b ekonomia Gjadër Mnelë"

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar Z.Mark Suli- inxhinjer specialist pranë zyres pyjeve Bashkia Vau Dejës, i cili relaton për këshilltarët se është marrë vendim për dhënie në përdorim e sipërfaqes së sipërcituar kërkohet çertifikata e pronësisë në emër të Bashkisë dhe pas aplikimit është çertifikuar 0.3 ha sipërfaqe e cila propozohet të jepet në përdorim në ndryshim nga sipërfaqja e miratuar në Vkb nr. 37, datë 24.05.2024.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Znj.Sanije Salja pyet: A ka afat për zbatimin faktik të këtyre projekteve?

Z.Mark Suli përgjigjet: Nga momenti i lidhjes së kontrates me fituesin Bashkia merr tarifat që ka subjekti fitues ndaj Bashkisë, dhe nëse subjekti fitues nuk ushtron aktivitet, në fund të mbarimit të kontrates, nuk i behet rinovimi, por bashkia gjate periudhes se kontrates i merr të ardhurat që subjekti i detyrohet.

Këshilltarët e tjerë nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:

Miratohet me 16 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim. Këshilltarët që votuan Pro piken e tetë të rendit të ditës: (Ervis Shimaj, Frano Prenga, Majlinda Ndreca, Rita Preçi, Neki Kapllanaj, Ermir Tahiri, Kastriot Shkjau, Albina Livadhi, Edona Molla, Besmir Kapaj, Sanije Salja, Samed Hasmegaj, Marin Dodaj, Franga Kola, Ornella Lleshi, Martin Mardoda.)

Z.Ervis Shimaj lexon piken e nëntë të rendit të ditës:



Projekt vendim "Për rishqyrtimin e Vendimit Nr.44, datë 29.08.2025 të Këshillit Bashkiak "Për dhënien në përdorim me afat 10 vjeçar për aerogjeneratorë sipërfaqe prej 5.3 ha dhe 5.258 km rrugë për lidhje me sipërfaqen në ekonominë pyjore Gjadër Mnelë"

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar Z.Mark Suli- inxhinjer specialist pranë zyres pyjeve Bashkia Vau Dejës, i cili relatton për këshilltarët se është marrë vendim për dhënie në përdorim e sipërfaqes së sipërcituar por institucioni i Prefektit Qarkut Shkodër e ka kthyer për procedurë jo të saktë të cënimit të konkurrimit publik.Projekt vendimi paraqitet për efekt të ndryshimit të procedurave ku në ndryshim nga Vkb e marrë, duhet të ndiqet procedura për dhënie në përdorim/heqjen nga fondi pyjor dhe kullësor publik mbështetur në Ligjin nr.57/2020 „Për pyjet“

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:

Miratohet me 16 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim. Këshilltarët që votuan Pro piken e nëntë të rendit të ditës: (Ervis Shimaj, Frano Prenga, Majlinda Ndreca, Rita Preçi, Neki Kapllanaj, Ermir Tahiri, Kastriot Shkjau, Albina Livadhi, Edona Molla, Besmir Kapaj, Sanije Salja, Samed Hasmegaj, Marin Dodaj, Franga Kola, Ornela Lleshi, Martin Mardoda.)

Z.Ervis Shimaj lexon piken e dhjetë të rendit të ditës:

Projekt vendim"Për rishqyrtimin e Vendimit Nr.45, datë 29.08.2025 të Këshillit Bashkiak "Për dhënien në përdorim me afat 10 vjeçar sipërfaqes prej 3 ha "Për aerogjeneratorë (stacionet, objektet përkatëse etj) dhe 4.063 km (4 km e 63 m) rrugë për tu lidhur me sipërfaqen që do të jepet në përdorim në ekonominë Gjadër Mnelë".

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar Z.Mark Suli- inxhinjer specialist pranë zyres pyjeve Bashkia Vau Dejës, i cili relatton për këshilltarët se është marrë vendim për dhënie në përdorim e sipërfaqes së sipërcituar por institucioni i Prefektit Qarkut Shkodër e ka kthyer për procedurë jo të saktë të cënimit të konkurrimit publik.Projekt vendimi paraqitet për efekt të ndryshimit të procedurave ku në ndryshim nga Vkb e marrë, duhet të ndiqet procedura për dhënie në përdorim/heqjen nga fondi pyjor dhe kullësor publik mbështetur në Ligjin nr.57/2020 „Për pyjet“

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:

Miratohet me 16 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim. Këshilltarët që votuan Pro piken e dhjetë të rendit të ditës: (Ervis Shimaj, Frano Prenga, Majlinda Ndreca, Rita Preçi, Neki Kapllanaj,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ermir Tahiri, Kastriot Shkjau, Albina Livadhi, Edona Molla, Besmir Kapaj, Sanije Salja, Samed Hasmeqaj, Marin Dodaj, Franga Kola, Ornela Lleshi, Martin Mardoda.)

Z.Ervis Shimaj lexon piken e njëmbëdhjetë të rendit të ditës:

Shqyrtim dhe diskutim i peticionit “Për hapjen e një çerdhe-kopështi publik me drekë në Bashkinë Vau Dejës.

Z.Ervis Shimaj sqaron këshilltarët se Këshillit Bashkiak i është drejtuar një peticion nga Qendra e Gruas “Hapa të lehtë” për hapjen e një çerdhe-kopështi publik me drekë në Bashkinë Vau Dejës. Shoqata ka paraqitur bashkëngjitur edhe firmëtarët e këtij peticioni ku rezultojnë 503 të tilla dhe ne si këshill bashkiak, kemi kërkuar nga zyra juridike për të parë bazueshmërinë ligjore të peticionit si dhe nga zyra e arsimit pranë bashkisë për tu shprehur me një relacion, kërkesa të cilat janë plotësuar. Qëllimi i peticionit është përfshirja në buxhetin e vitit 2026 të Bashkisë Vau Dejës hapja e një çerdhe-kopështi publik me drekë në Bashkinë Vau Dejës.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Znj.Saniqe Salja- Është shumë e drejtë kjo kërkesë sepse ndikon pozitivisht në komunitet.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim peticionin. **Miratohet me 16 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim.** Këshilltarët që votuan Pro piken e njëmbëdhjetë të rendit të ditës: (Ervis Shimaj, Frano Prenga, Majlinda Ndreca, Rita Preçi, Neki Kapllanaj, Ermir Tahiri, Kastriot Shkjau, Albina Livadhi, Edona Molla, Besmir Kapaj, Sanije Salja, Samed Hasmeqaj, Marin Dodaj, Franga Kola, Ornela Lleshi, Martin Mardoda.)

Pika 12: Të ndryshme;

Z.Ermir Tahiri-Është problematikë shkolla e fshatit Kosmaçë sepse pikon uji nga çatia.Kërkoj që të bëhen disa riparime në drejtim të përmirësimit të kushteve sepse është edhe shkolla që ka numrin më të madh të nxënësve.

Z.Ervis Preçi – Zv/Kryetar Bashkie, përgjigjet se kemi bërë kërkesë pranë Ministrisë Arsimit për të bërë rikonstruktion të plotë të kësaj shkolle dhe presim të na miratohet, por riparimet e vogla emergjente do bëhen nga ana jonë si Bashki.

Z.Ermir Tahiri bën propozim për rastet kur këshilltarët mungojnë në mbledhjet e radhës së këshillit Bashkiak apo mbledhje të komisioneve pa arsye, a kemi bazë ligjore për të zbritur masen e shpërblimit sepse mungesat pa arsye janë mungesë serioziteti në lidhje me përfaqesimin që ka këshilltari në raport me komunitetin.

Z.Ervis Shimaj përgjigjet se do komunikojmë zyrtarisht me zyren juridike pranë Bashkisë për të parë hapsirat ligjore për këtë qëllim.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Mbledhja e Kshillit Bashkiak e datës 26.11.2025, deklarohet e mbyllur nga Kryetari Këshillit.

Mbajtësi i Protokollit

Sekretari Këshillit

Ardian ÇELEPIJA



Këshilltarët:

- | | |
|----------------------------|------------------------|
| 1. <u>Erris Shimoj</u> | 16. <u>Edona Molla</u> |
| 2. <u>Samir Hasunaga</u> | 17. _____ |
| 3. <u>Dorina Basha</u> | 18. _____ |
| 4. <u>Neli Uopllana</u> | 19. _____ |
| 5. <u>Ermona Tola</u> | 20. _____ |
| 6. <u>Frano Prenga</u> | 21. _____ |
| 7. <u>Ornela Lleshi</u> | 22. _____ |
| 8. <u>Kajmole Udhuro</u> | 23. _____ |
| 9. <u>Rita Preçi</u> | 24. _____ |
| 10. <u>Masstrat Shkja</u> | 25. _____ |
| 11. <u>Ermir Tahiri</u> | 26. _____ |
| 12. <u>Allina Liva</u> | 27. _____ |
| 13. <u>Besmir Kopaj</u> | 28. _____ |
| 14. <u>Senye Saka</u> | 29. _____ |
| 15. <u>Martin Moroloda</u> | 30. _____ |
| | 31. _____ |